

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7140
E mërkurë, 13 mars 2024
Çmimi 0.50 €

Von der Leyen konfirmon
rekomandimin për nisjen e
negociatave për anëtarësimin
e Bosnjës | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

I DËRGUARI I SHTETEVE TË BASHKUARA PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, KA BASHKËBISEDUAR ME GAZETARË NË BRUKSEL | FAQE 4-5

ESCOBARI: KEMI PROBLEME NË KOMUNIKIM ME KRYEMINISTRIN KURTI



Në një konferencë për medie, i deleguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka pranuar se ShBA-ja ka probleme në komunikim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Probleme në

komunikim me Kurtin, sipas Escobarit, nuk ka vetëm ShBA-ja, por edhe pjesa tjetër e botës perëndimore. "Partneriteti në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës, mes popullit amerikan dhe atij të Kosovës, nuk depërton

përmes një njeriu në Kosovë apo një partie. Mirëpo, më duhet të them se aktualisht kemi probleme në komunikim me kryeministrin", ka thënë Escobari, duke shtuar se vendimi i BQK-së për dinarin është katastrofik

ARSENALIT TË
FSK-SË I SHTOHEN
KAMIONË
USHTARAKË
MULTIFUNKSIONALË
TË PRODHIMIT
GJERMAN | F. 3



MINISTRJA GËRVALLA
NË NATO: KOSOVA
ËSHTË DËSHMUAR
SI KONTRIBUTDHËNËSE
PËR PAQE DHE SIGURI
NË RAJON | F. 7



DISKUTOHET PËR MUNDËSITË E
ORGANIZIMIT TË NJË FORUMI TË
PËRBASHKËT EKONOMIK NË MES TË
KOSOVËS DHE BANGLADESHIT | F. 8

15 STACIONE TË REJA TË INTERNETIT
NË VERI, KURTI: 140 MBPS ËSHTË
SHPEJTËSIA E INTERNETIT NË ÇABËR
TË ZUBIN POTOKUT | F. 8

SPORT



SOT TRI NDESHJE NË SUPERLIGË,
DERBI MALISHEVA - LLAPI | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji
BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Von der Leyen konfirmon rekomandimin për nisjen e negociatave për anëtarësimin e Bosnjës

BRUKSEL, 12 MARS - Presidentja e Komisionit Evropian (KE), Ursula von der Leyen, ka konfirmuar të martën se komisioni do ta rekomandojë nisjen e negociatave për anëtarësimin e Bosnjë-Hercegovinës në Bashkimin Evropian (BE).

Duke folur në Parlamentin Evropian (PE), Von der Leyen theksoi se raporti i përpiluar nga Komisioni Evropian dëshmon përparimin që e ka arritur Bosnjë-Hercegovina, prandaj edhe i ka rekomanduar Këshillit të vendosë për nisjen e negociatave të anëtarësimit me vendin ballkanik. "Prej kur i dhamë statusin e kandidatit, Bosnjë-Hercegovina ka bërë hapa mbresëlënës drejt nesh. Më shumë përparim është arritur gjatë pak më shumë se një viti

sesa gjatë një dekade", tha Von der Leyen, duke i numëruar disa rezultate, përfshirë edhe faktin se Bosnjë-Hercegovina tash e ka nivelin e përshtatjes 100 për qind me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Ndër arritjet e tjera, sipas saj, janë edhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përfshirja e dënimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës në Hagë në regjistrin shtetëror të krimeve dhe disa rezultate të tjera. "Kjo është arsye pse ne sot vendosim t'i rekomandojmë Këshillit t'i hapë negociatat për anëtarësim me Bosnjë-Hercegovinën. Mesazhi nga Bosnjë-Hercegovina është i qartë. Prandaj edhe mesazhi ynë duhet të jetë i qartë: e ardhmja e Bosnjë-Hercegovinës është në Bashkimin Evropian", tha ajo.

Pas rekomandimit të Komisionit Evropian, vendimin për nisjen e negociatave duhet ta marrin liderët e 27 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo do të jetë në rend të ditës në një samit që do të zhvillohet më 21 dhe 22 mars në Bruksel.

Në procesin e zgjerimit aktualisht ndodhen 10 vende. Prej këtyre, nëntë kanë status kandidatit dhe vetëm Kosova është vend i cili nuk e ka një status të tillë, edhe pse ka aplikuar për anëtarësim në bllok. Turqia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Ukraina dhe Moldavia kanë edhe vendimin për nisjen e negociatave për anëtarësim. Statusi kandidatit kanë edhe Bosnjë-Hercegovina dhe Gjeorgjia, por deri tash nuk kanë vendim për nisjen e negociatave.



Vatikani: Kushti i parë për paqe në Ukrainë është që Rusia ta ndalë agresionin



VATIKAN, 12 MARS - Vatikani ka thënë të martën se "kushti i parë" për arritjen e paqes në Ukrainë është që Rusia "t'i japë fund agresionit të saj", pas kritikave nga Kiev dhe aleatët e tij ndaj deklaratave të Papa Françeskut. Papa Françesku tha në një intervistë më 9 mars se Ukraina duhet ta ketë "guximin" për t'u ulur dhe për të biseduar me Rusinë për paqe, duke shtuar se nuk është turp ta valosh "flamurin e bardhë".

Kardinali Pietro Parolin, sekretar i Shtetit të Vatikanit dhe bashkëpunëtori më i afërt i papës, i bëri këto komente në një intervistë për gazetën italiane "Corriere della Sera" të martën.

"Selia e Shenjtë e ndjek këtë qëndrim dhe vazhdon të kërkojë armëpushim - dhe agresorët janë ata të cilët duhet ta ndalin luftën", tha Parolin.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e kritikoi Françeskun pa ia përmendur emrin duke thënë se "kisha duhet të jetë me popullin. Dhe, jo 2 500 kilometra larg, diku, të ndërmjetësojë virtualisht mes dikujt që dëshiron të jetojë dhe dikujt që dëshiron të të shkatërrojë".

Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, reagoi më drejtpërdrejt në rrjetet sociale, duke thënë se "flamuri ynë është verdhekaltër. Me këtë flamur ne jetojmë, vdesim dhe triumfojmë.

Ne nuk do të ngremë kurrë të tjerë flamuj".

Zelensky ka ngulur këmbë se nuk do të flasë drejtpërdrejt me Rusinë nëse kushtet e "formulës" së tij për paqe nuk plotësohen.

Kërkesat e Ukrainës për paqe janë që Rusia t'i tërheqë të gjitha trupat e veta nga Ukraina, t'i kthejë kufijtë e vet nga epoka pas rënies së Bashkimit Sovjetik më 1991 dhe Rusia të mbahet përgjegjëse për veprimet e saj.

Deklaratat e Françeskut u kritikuan edhe nga aleatët e Ukrainës, si Polonia dhe Lituania. Ndërsa shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se Ukraina ka nevojë për armë, jo për flamuj të bardhë.

Komuniteti i inteligjencës amerikane: Dodiku po merr hapa për shkëputjen de facto të Republikës Sërpska

WASHINGTON, 12 MARS - Ballkani Perëndimor mbase do të përballet me një rrezik të shtuar të dhunës së lokalizuar ndëretnike gjatë vitit 2024, posaçërisht në Bosnjë-Hercegovinë, ku lideri i serbëve të Bosnjës, Millorad Dodik, synon shkëputjen de facto të Republikës Sërpska, dhe në Kosovë ku tensionet u rritën skajshëm vitin e kaluar, tha komuniteti i inteligjencës amerikane në një raport të vlerësimit vjetor të kërcënimit në botë. "Liderët nacionalistë ka shumë të ngjarë t'i acarojnë tensionet për përfitime politike, ndërsa aktorët e jashtëm do t'i shfrytëzojnë dallimet etnike për ta rritur apo mbrojtur



ndikimin e vet rajonal, apo për të mos e lejuar integrimin më të madh të Ballkanit në institucionet euroatlantike dhe të Bashkimit

Evropian", thuhet në raportin e publikuar muajin e kaluar. Dodik, presidenti i Republikës Sërpska, është duke u përpjekur

tash e dy vjet që entiteti i Bosnjë-Hercegovinës ta marrë pushtetin e shtetit dhe të krijojë institucione paralele, duke kërcënuar se Republika Sërpska do të ndahet nga Bosnjë-Hercegovina përgjithmonë.

Për shkak të "aktiviteteve të tij kundër marrëveshjes së Dejtonit", Dodiku është në listën e sanksioneve të Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe.

Dodiku më herët ka deklaruar se nuk ka frikë nga paralajmërimet amerikane dhe ka kërcënuar se do ta kthejë kufirin e entitetit në kufi shtetëror.

Ambasada Amerikane në Sarajevë

paralajmëron për rrezikun e politikës separatiste të Dodikut, duke deklaruar se ajo "vë në rrezik perspektivën evropiane të Bosnjë-Hercegovinës, demokracinë dhe ekonominë e saj".

Roli i drejtorit të Inteligjencës Kombëtare Amerikane është ta mbikëqyrë dhe ta drejtojë zbatimin e Programit të Inteligjencës Kombëtare dhe të veprojë si këshilltar parimor i presidentit amerikan, i Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe i Këshillit të Sigurisë Kombëtare të Atdheut për çështjet e inteligjencës në lidhje me sigurinë kombëtare. Ai emërohet nga presidenti me këshillimin dhe pajtimin e Senatit.

Spanca: Zbatimi i rekomandimeve, sfidë për ZKA-në

PRISHTINË, 12 MARS - Në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, kryesuar nga kryetarja Hykmete Bajrami, u diskutua të martën për zbatimin e rekomandimeve nga organizatat buxhetore, në veçanti ato të dhëna nga Kuvendi/Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjatë vitit 2022/2023. Me këtë rast, auditorja e

përgjithshme, Vlora Spanca, dha sqarimet e nevojshme në komision, ndërkaq anëtarët e komisionit ngritën çështje të ndryshme rreth këtij procesi. Ajo foli për nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga organizatat buxhetore, duke theksuar se ka përparim në zbatimin e rekomandimeve, megjithatë edhe kjo çështje ende mbetet sfidë. Për këtë përparim ajo

përmendi ndërmarrjet publike. Më tutje, në kryesimin e zv/kryetares Arta Baralija, komisioni shqyrtoi propozim-rekomandimet për Raportin e auditimit të performancës "Renovimi dhe rikonfigurimi i stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë". Me këtë rast u vendos që propozim-rekomandimet të procedohen në seancë.



Arsenalit të FSK-së i shtohen kamionë ushtarakë multifunksionalë të prodhimit gjerman



Kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, panë të martën nga afër flotën e kamionëve ushtarakë multifunksionalë RheinMetall MAN HX2, 8X8 të cilët i janë shtuar arsenalit të ushtrisë. Kamionët ushtarakë RheinMetall MAN HX2 janë prodhim gjerman. Nga 15 gjithsej, 10 janë blerë me buxhet të shtetit, ndërkaq pesë janë donacion. Këta kamionë multifunksionalë janë të pajisur me teknologji moderne dhe janë të dizajnuar për operacione logjistike, veçanërisht taktike

kamioni të pastër ushtarak janë shumë mbresëlënëse. Falë sistemeve të ndryshme të asistencës, HX2 u ofron ushtarëve dhe mjedisit civil siguri më të madhe në

përdorimin e përditshëm të automjeteve dhe garanton dukshëm më shumë mbrojtje në kabinë", tha ministri Maqedonci, duke shtuar se menaxhimi i flotës në këta

kamionë gjithashtu bëhet më i thjeshtë dhe më efikas, ndërsa konfigurimi i përgjithshëm mundëson transportimin e municioneve në terrene të vështira.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, panë nga afër flotën e kamionëve ushtarakë multifunksionalë RheinMetall

MAN HX2, 8X8 të cilët i janë shtuar arsenalit të ushtrisë. Nga gjithsej 15 kamionë, 10 janë blerë me buxhet të shtetit, ndërkaq pesë janë donacion. Ministri Maqedonci theksoi se këta kamionë janë ndër më modernët, multifunksionalë, të dizajnuar për operacione logjistike dhe taktike. "Karakteristikat e reja të këtij

UP-ja dhe Universiteti Teknik i Pryazovskitt nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 12 MARS - Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me Universitetin Teknik të Pryazovskit në Ukrainë. Ky bashkëpunim shtrihet në disa dimensione, duke përfshirë shkëmbimet e studentëve dhe stafit,

projektet e përbashkëta kërkimore, si dhe zhvillimin e programeve të përbashkëta arsimore. Në veçanti, për studentët e Universitetit të Prishtinës kjo marrëveshje hap rrugën për shfrytëzimin e mundësive të shumta për shkëmbime akademike, duke ofruar një

përvojë të pasur edukative ndërkombëtare. UP-ja vazhdon ta avancojë cilësinë dhe t'i zgjerojë mundësitë për zhvillimin e studentëve, duke rikonfirmuar kështu përkushtimin për përmirësimin e përvojës edukative dhe përgatitjen e studentëve për sfidat globale.



I DËRGUARI I SHTETEVE TË BASHKUARA PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR, KA BASHKËBISEDUAR ME GAZETARË NË BRUKSEL

Escobari: Kemi probleme në komunikim me kryeministrin Kurti

Në një konferencë për medie, i deleguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka pranuar se ShBA-ja ka probleme në komunikim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Probleme në komunikim me Kurtin, sipas Escobarit, nuk ka vetëm ShBA-ja, por edhe pjesa tjetër e botës perëndimore. “Partneriteti në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës, mes popullit amerikan dhe atij të Kosovës, nuk depërton përmes një njeriu në Kosovë apo një partie. Mirëpo, më duhet të them se aktualisht kemi probleme në komunikim me kryeministrin”, ka thënë Escobari, duke shtuar se vendimi i BQK-së për dinarin është katastrofik

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 MARS - I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka quajtur “katastrofik” dhe “jokompetent” vendimin e autoriteteve të Kosovës për ta zbatuar rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës që përcakton euron valutën e vetme për kryerje të pagesave me para të gatshme. Me këtë vendim është

pamundësuar përdorimi i dinarit serb në komunat me shumicë serbe në Kosovë.

Ai i ka bërë këto deklarata në Bruksel gjatë një bashkëbisedimi të hapur me gazetarë. “I bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës t’i ketë parasysh shqetësimet e komunitetit serb dhe mekanizmit ndërkombëtarë për trajtimin e minoriteteve brenda Kosovës”, ka thënë Escobari.

Ai ka rikujtuar se Francës i është dashur gati një vit për ta adoptuar

euron, përderisa “në veri të Kosovës kanë dashur ta zbatojnë vendimin brenda 3 javëve”.

Escobari ka përsëritur që Shtetet e Bashkuara nuk e kundërshtojnë legjitimitetin e vendimit, mirëpo kanë probleme me mënyrën e zbatimit dhe për efektin që ka te komuniteti serb.

Qysh prej 10 marsit e deri më 18 mars Escobari do të realizojë një mori takimesh në Belgjikë, Kosovë, Austri dhe Mal të Zi.

Escobari pritet t’i nisë takimet në Prishtinë më 13 mars.

Ai ka thënë se gjatë vizitës në Prishtinë do të ketë në fokus një “zgjidhje të mundshme për vendimin e pakoordinuar për ta ndaluar dinarin si dhe për transferet prej Serbisë për qytetarët e Kosovës të cilët varen prej tyre”.

Serbia deklaroi se ndan miliona euro për serbët në Kosovë dhe ua paguan atyre rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

I pyetur pse nuk po e viziton edhe Maqedoninë e Veriut, ai ka thënë se situata në Kosovë është “e tmerrshme, prandaj më duhet ta vizitoj Kosovën”.

Escobari e ka konsideruar dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë të nisur qysh më 2011, me ndërmjetësim të Bashkimit

Evropian - “në një moment kritik”. Ai e ka pranuar se Uashingtoni ka probleme në drejtimin e marrëveshjeve të Brukselit dhe asaj të Ohrit “në rrugën e duhur” dhe që, sipas perspektivës amerikane, “nuk ekziston asnjë alternativë përveç dialogut”.

I pyetur për pasojat e mundshme ndaj Kosovës dhe Serbisë për moszbatim të marrëveshjes së Ohrit, Escobari ka thënë se Prishtina zyrtare duhet ta nisë punën për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërsa Serbia t’i konsiderojë obliguese zotimet e bëra. Sipas tij, pasojë e mospërbushjes së zotimeve të marrëveshjeve do të jetë ngadalësimi në rrugën e integriteteve evropiane. “E inkurajojmë Kosovën të ecë para, Asociacioni nuk do të jetë një Republikë Srpska, nuk ka shtet brenda shtetit, nuk ka asgjë në statut që lejon një autoritet ekzekutiv ose fuqi ekzekutive. Kemi dëgjuar shumë arsye pse s’është dërguar në Kushtetuese, apo ecur përpara, por ne i refuzojmë të gjitha. Duhet të ecë përpara sa më parë”, ka pohuar ai. Escobari ka pranuar se ekziston një çarje në komunikimet diplomatike mes ShBA-së dhe

Kosovës. “Partneriteti në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës, mes popullit amerikan dhe atij të Kosovës, nuk depërton përmes një njeriu në Kosovë apo një partie. Mirëpo, më duhet të them se aktualisht kemi probleme në komunikim me kryeministrin [e Kosovës, Albin Kurtin]. Dhe jo vetëm ShBA-ja, është problem që e ka Kosova edhe me BE-në, NATO-n, Mbretërinë e Bashkuar dhe më shumë partnerë, përfshirë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut”, ka thënë Escobar. Ai ka thënë se komunikimi me Kosovën ka qenë shumë i mirë në të kaluarën dhe shpreson që e njëjta situatë do të jetë edhe në të ardhmen.

I pyetur se a kanë ndryshuar politikat amerikane ndaj Kosovës dhe Serbisë, pas nisjes së luftës së Rosisë në Ukrainë në shkurt të vitit 2022, Escobari ka thënë se nuk ka ndodhur diçka e tillë. “Mirëpo, ka ndryshuar urgjenca që ekziston për adresim të sfidave për stabilitetin evropian brenda kontinentit të Evropës”, ka thënë ai. Në këtë drejtim, Escobari ka vlerësuar se është shumë urgjente “të nisim të zgjidhim disa pyetje të hapura në Ballkanin Perëndimor”.

Përzgjedhja e kryeprokurorit mund të përfundojë tek Avokati i Popullit

PRISHTINË, 12 MARS - Ka gati dy vjet që pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës e mban një ushtrues detyre. Me gjithë thirrjet e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare - të fundit më 2 mars - për ta emëruar atë, nuk ka ende asgjë konkrete. Çështja është shndërruar tashmë në një betejë të dukshme mes Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. Kjo e fundit nuk e dekretoi Blerim Isufajn në pozitën në fjalë në tetor të vitit të kaluar, duke thënë se ka pasur disa shkelje ligjore në procesin e përzgjedhjes së tij. KPK-ja e kishte propozuar emrin e tij qysh në prill të vitit 2022.

Tani, gati pesë muaj pas mosdekretimit të Isufajt, KPK-ja paralajmëron mundësinë e dërgimit të çështjes tek Avokati i Popullit. "Kjo çështje do të shqyrtohet në njërin nga takimet e radhës së KPK-së dhe do t'ju mbajmë të informuar në kohë reale për hapat e mëtejshëm", tha Bedri Gashi, udhëheqës i Njësisë për Komunikim Publik pranë KPK-së, për Radion Evropa e Lirë, më 8 mars.

Petrit Çollaku, zyrtar për komunikim tek Avokati i Popullit, i tha REL-it të hënën se deri më tash ky institucion nuk ka pranuar

ndonjë ankesë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës lidhur me mosdekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit. "Në rast se pranohet një kërkesë e tillë, padyshim se e njëjta do të trajtohet në përputhje me mandatin që ka Avokati i Popullit dhe në bazë të legjislacionit në fuqi", tha ai në përgjigjen me shkrim.

REL-i kërkoi koment edhe nga Presidenca e Kosovës për këtë temë, por ajo nuk u përgjigj.

Si e komentojnë ekspertët?

Vullnet Bugaqku, hulumtues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), thotë për Radion Evropa e Lirë se dërgimi i çështjes tek Avokati i Popullit do të ishte një hap i mirë për ta sqaruar përfundimisht atë. "Besoj se Avokati i Popullit, pas pranimit të kërkesës së KPK-së, mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për interpretim, nëse vendimi i presidentes për mosdekretim është jokushtetues dhe nëse i cenon kompetencat e KPK-së si organ i pavarur kushtetues", thotë Bugaqku.

Ai sqaron se Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës, ka të drejtë ta kontestojë në Gjykatë Kushtetuese

Pse nuk u dekretua Isufaj?

Disa nga shkeljet që u evidentuan nga Presidenca e Kosovës gjatë procedurës për përzgjedhjen e Kryeprokurorit ishin:

Shmangia nga zbatimi i kriterëve ligjore në përzgjedhjen e Kryeprokurorit të shtetit; Mohimi i mundësisë për mjet ankimor efektiv brenda KPK-së për kandidatët e pakënaqur përmes propozimit arbitrar të raportit të komisionit për rishqyrtim të kundërshtimeve; Shkelje në procedurat e vlerësimit të reputacionit profesional të kandidatëve; Shkelje në procedurat e vlerësimit të integritetit të kandidatëve; Shkelje në procedurat e vlerësimit të koncept-dokumentit dhe prezantimit të tij nga kandidatët, e të tjera. KPK-ja, atëkohë, i cilësoi si të pabaza këto arsye dhe tha se janë "jashtëzakonisht tendencioze".

çdo ligj, akt apo dekret të presidentes apo qeverisë, nëse vlerëson se akti i tillë cenon Kushtetutën e Kosovës.

Por, shton Bugaqku, me dërgimin tek Avokati i Popullit, me gjasë edhe në Gjykatën Kushtetuese, procesi i zgjedhjes së kryeprokurorit do të zvarritej edhe më shumë. "Procesi tashmë është i prolonguar dhe ka marrë kohë gati dy vjet. Kështu që ndjekja e një rrugë të tillë - ndonëse do ta zvarriste këtë proces, sepse Gjykata [Kushtetuese] mund të vonojë në dhënien e përgjigjes - prapëseprapë do të ishte një hap që do të mund t'i jepte zgjidhje këtij procesi", thotë Bugaqku.

Ndryshe prej tij mendon Ehat

Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ai thotë se Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk duhet t'i drejtohet Avokatit të Popullit për këtë çështje pasi që, sipas tij, një gjë e tillë do të shkaktonte edhe më shumë vonesa. "KPK-ja mund ta prolongojë sa të dojë këtë proces por, sigurisht, kjo nuk u shërben parimeve të sundimit të ligjit, nuk i shërben integritetit të sistemit prokurorial. Në këtë drejtim, unë e shoh që kjo e zgjat procesin, por nuk rregullon diçka", thotë Miftaraj për Radion Evropa e Lirë.

Për të dalë nga kjo situatë, thotë ai, "duhet të shpallet një konkurs i ri, një proces i bazuar në meritokraci, një proces i paanshëm, i pavarur,

në mënyrë që kandidati që propozohet, të dekretohet nga presidenti i Republikës".

Në garë për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç Blerim Isufajt, ishin edhe Armend Hamiti, Lulzim Sylejmani, Shqipdon Fazliu dhe Kujtim Munishi.

Tri organizata joqeveritare - Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja Fol dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike - të cilat i monitoruan procedurat e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit nga KPK-ja, vlerësuan se procesi ka pasur të meta të shumta. Sipas tyre, paneli vlerësues i kishte vlerësuar kandidatët në mënyrë të pabazuar "duke cenuar meritokracinë e procesit".

ShBA-ja e kritikoi, po ashtu, procesin e KPK-së, sikurse edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë.

Kryeprokurori i Shtetit është pozitë e rëndësishme në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Ky post ka një mandat prej shtatë vjetësh.

Mandati i Kryeprokurorit paraprak, Aleksandër Lumezi, skadoi në prill të vitit 2022. Aktualisht ushtrues i kësaj detyre është Besim Kelmendi, i cili i ka kompetencat e plota të Kryeprokurorit të Shtetit.



Filluan punimet për ndërtimin e rrugëve që ndërlidhin e afrojnë fshatrat e Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugëve që ndërlidhin e afrojnë fshatrat e Kosovës dhe të Shqipërisë. "Sot, shënuam fillimin e

punimeve për rehabilitimin dhe zgjerimin e Rrugëve Ndërkufitare, që ndërlidhin fshatrat Kërstec-Pakishtë-Zapod, konform marrëveshjes së bashkëpunimit Kosovë-Shqipëri. Kjo rrugë me gjatësi prej 6.3 km dhe me një investim prej më shumë

se 2.3 milionë euro, do të sjellë zhvillim ekonomik, e njëherit do hap perspektivën e turizmit malor, që do të shërbejë si portë hyrëse për të gjithë Shqiptarët kudo që janë, për të eksploruar bukuritë natyrore të kësaj zone!", ka shkruar Aliu në "Facebook".



Komisioni për Administratë Publike shqyrtoi raportin e punës për vitin 2023 dhe analizoi objektivat

PRISHTINË, 12 MARS - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, i drejtuar nga Valon Ramadani, kryetar, mbajti të martën mbledhjen e radhës, në të cilën u diskutua për disa çështje kyçe, të cilat kanë të bëjnë me punën e komisionit. Në këtë mbledhje anëtarët e komisionit shqyrtojnë raportin e punës për vitin 2023, duke analizuar realizimin e objektivave të vendosura për

këtë periudhë dhe duke identifikuar sfidat dhe arritjet e bëra. Po ashtu, komisioni shqyrtoi draft-planin e punës për sesionin pranveror për vitin 2024. Anëtarët e komisionit shqyrtojnë objektivat e propozuara për këtë periudhë, duke plotësuar dhe ndryshuar draft-planin me tema të ndryshme të cilat planifikohet të trajtohen në këtë sesion. Gjithashtu, në këtë mbledhje u shqyrtojnë në parim dy

projektligje: Projektligji për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës dhe Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës. Prezantimin dhe arsyetimin e tyre e bëri ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, sipas të cilit, këto projektligje rregullojnë çështje që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm publik.



Kurti: Serbia agresive na bën të kujdesshëm

PRISHTINË, 12 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të martën, gjatë përrurimit të një Qendre Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike në Prishtinë, se "e kemi të qartë se fqinjë ynë verior është agresiv", duke iu referuar Serbisë. "Mirëpo, kjo na bën të kujdesshëm, assesi të frikësuar", tha Kurti për gazetarë. Kurti theksoi se Kosova është duke u përgatitur maksimalisht me "krejt çfarë mundemi dhe dimë", prandaj edhe e ka hapur qendrën e cila do të ofrojë trajnime për sigurinë kibernetike. "Konfliktet nuk janë ndërretnike. Nuk është dallimi etnik ai që shkakton konflikt, por është autokracia në Beograd, e ndërlidhur me despotizmin në Moskë", shtoi ai. Kryeministri i Kosovës tha se ka paralajmëruar prej kohësh që

"shtetet jodemokratike edhe në rajonin tonë, jo vetëm në Lindje të Evropës, janë rrezik për sigurinë dhe paqen, por natyrisht që këtë gjë hollësisht dhe thellësisht sikur Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund ta dijë askush". Shtatorin e kaluar Kurti kishte thënë se "aleatët e Rusisë", përmes dezinformimit dhe sjelljeve të tjera dashakeqe në fushën kibernetike, po ndikojnë në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në Kosovë e kanë akuzuar edhe më herët Rusinë se po shtyn aleaten e saj, Serbinë, të nxisë tensione në vendin fqinj, ndonjëse pretendimet e tilla janë hedhur poshtë nga Rusia. Në një raport të organizatës "Demokracia Plus", të publikuar



më 2022, thuhej se Kosova "është subjekt i dezinformimit nga aktorë malinj të huaj, si Rusia, Kina dhe Serbia". Sulmet e fundit të raportuara kibernetike ndaj institucioneve shtetërore kanë ndodhur në shtator të vitit 2022. Qeveria e Kosovës tha atëkohë se sulmi e

kishte origjinën jashtë vendit, por nuk tregoi se nga cili vend. Institucionet shtetërore kanë qenë cak i sulmeve kibernetike edhe më herët. Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë u rritën shtatorin e kaluar, kur një grup i serbëve të armatosur e sulmoi Policinë e

Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke e vrarë një rreshter të Kosovës. Gjatë përleshjeve që pasuan, u vranë tre sulmues serbë. Më 13 shkurt Kurti tha se, duke mos pranuar ta nënshkruajë Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, po e lë të hapur mundësinë "e pushtimit të Kosovës". Shkurtin e kaluar, Kosova dhe Serbia u pajtuan në Bruksel për këtë marrëveshje, ndërkaq në prill në Ohër u arrit pajtimi për Aneksin e zbatimit të saj. Megjithatë, palët nuk e nënshkruan marrëveshjen, por blloku evropian, që ndërmjetëson dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, tha se ajo është obliguese për palët.

Kryeprokurori i Shtetit takon përfaqësuesit e ekipit vlerësues të INL-së për sektorin e drejtësisë në Kosovë



Prishtinë, 12 mars - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka pritur në takim pune përfaqësuesit e ekipit vlerësues të INL-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, kryesuar nga Michael Wasco, këshilltar i lartë për çështje të Drejtësisë në Byronë e Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe të Çështjeve të Zbatimit të Ligjit që gjendet në kuadër të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Dafina Bardhi - Rexhepi, specialiste e Programeve në INL pranë Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Gjatë këtij takimi, u. d. kryeprokurori Kelmendi i njoftoi të pranishmit me rolin, strukturën, funksionimin dhe kompetencat e institucionit të Prokurorit të Shtetit. Po ashtu, kryeprokurori Kelmendi gjatë këtij takimi ka folur edhe për zhvillimin e procesit të vlerësimit të performancës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve të shtetit, procedurat e avancimit në karrierë, si dhe funksionimin e mekanizmave disiplinorë, konkretisht për procedurat e inicimit të rasteve ndaj prokurorëve. Temë e diskutimeve të

përbashkëta në këtë takim ishte edhe mbështetja e vazhdueshme e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhënë për institucionin e Prokurorit të Shtetit në funksion të forcimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Në fund të takimit kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, falënderoi Wasco për vizitën në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, me ç'rast ka vlerësuar lart ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhënë për nevojat e sistemit prokurorial.

Delegacioni nga Universiteti Savonia i Finlandës viziton UP-në

PRISHTINË, 12 MARS - Prorektorja Basha-Jakupi, së bashku me prorektorin Breznica-Selmani dhe përfaqësuesen nga ZMJ-ja, Bleranda Dragusha, kanë pritur një delegacion nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara Savonia në Kuopio, Finlandë, për një vizitë shkëmbimi ERASMUS+ me Universitetin e Prishtinës. Në vizitë po marrin pjesë dy

profesoresha, Johanna Komulainen dhe Tuija Pakarinen, të cilat do të zhvillojnë orë mësimi bashkë si dhe 11 studentë të studimeve sociale, të cilët po bashkëpunojnë me profesoreshën Vjollca Krasniqi. Aktualisht, studentja Tanja Lunden nga ky universitet është në punë praktikë në një nga

organizatat partnere të Departamentit të Punës Sociale në UP. Universiteti i Shkencave të Aplikuara Savonia është një partner i rëndësishëm universitar dhe në UP po shqyrtohen modalitetet e bashkëpunimit përtej shkëmbimit ERASMUS+ të stafit dhe studentëve.



"Termokos"-i ndau bursa për studentët e UP-së

PRISHTINË, 12 MARS - Në një ceremoni të organizuar në rektorat, ngrohtorja e qytetit "Termokos" ka ndarë 15 bursa për studentët e UP-së nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM), Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN). Bursat u dorëzuan në prani të

rektorit të UP-së, prof. Qerim Qerimi, nënkryetares së komunës së Prishtinës, Jehona Lushaku-Sadriu, kryeshefit ekzekutiv të NP "Termokos", Fisnik Osmani, dekanëve të tre fakulteteve teknike, prorektorëve të UP-së, menaxhmentit dhe aksionarëve të ndërmarrjes, si dhe studentëve të zgjedhur për të

përfituar nga bursat. Në fjalën e tij, rektori Qerimi falënderoi NP "Termokos" për këtë nismë të rëndësishme dhe u shpreh i gëzuar për mundësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen, duke e përshkruar këtë veprim si një gjest shumë fisnik drejt përmirësimit të

mundësive arsimore për studentët e UP-së dhe kontribut konkret drejt përgatitjes së kuadrit të ardhshëm profesional. Rektori ka inkurajuar edhe institucionet e tjera publike dhe partnerët e tjerë që ta shqyrtojnë mundësinë e mbështetjes së studentëve përmes ofrimit të bursave dhe praktikave



profesionale. Përzgjedhja e studentëve është bërë nga fakultetet përkatëse dhe vlera individuale e bursës është 700 euro.

Inaugurohet Qendra Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Në Kazermën e FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë u mbajt të martën ceremonia e inaugurimit të Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike. Në këtë inaugurim morën pjesë kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, drejtori i NALI, gjeneralbrigade Ralf Peter Hammerstein, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, si dhe zyrtarë dhe oficerë të lartë të MM/FSK si dhe të vendeve partnere ndërkombëtare.

Në fjalën e tij, drejtuar të pranishmëve në këtë ceremoni, kryeministri Kurti ka theksuar se ndien kënaqësi për shënimin e një momenti të rëndësishëm në rrugën që po e ndjek edhe Kosova drejt një hapësire kibernetike më të sigurt, duke shtuar se inaugurimi i kësaj qendre paraqet një angazhim, përkushtim dhe arritje domethënëse në këtë drejtim. "Viti i kaluar ka qenë vit i progresit të shumë iniciativave dhe politikave tona në fushën e sigurisë kibernetike. Trajnimet që do të bëhen në këtë qendër do t'i adresojnë objektivat qenësore për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për sigurinë kibernetike dhe krijimin e vetëdijes kolektive për rreziqet kibernetike", ka thënë Kurti.

Ndërsa ministri Maqedonci në



fjalën e tij ka bërë me dije se Qendra Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike do të ofrojë trajnime me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike, do t'i përmirësojë aftësitë profesionale dhe të ndihmojë në

ngritjen e niveleve të sigurisë kibernetike të institucioneve qeveritare, operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale, për t'i arritur kapacitetet për mbrojtjen e infrastrukturës kritike në vend. Po ashtu, ministri

Maqedonci ka falënderuar kryeministrin Kurti, Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ambasadën e ShBA-së, të cilët mundësuan realizimin e këtij projekti me interes të lartë shtetëror.

Kurrikula për Qendrën Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike, që përbën një element thelbësor në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, është hartuar në mbështetje nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe është implementuar nga Qendra e Gjenerës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF) me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Përmes zbatimit të kësaj kurrikule kjo qendër përbën një shtyllë të re të rëndësishme të mbrojtjes së sigurisë së vendit.

Ministrja Gërvalla në NATO: Kosova është dëshmuar si kontributdhënëse për paqe dhe siguri në rajon



PRISHTINË, 12 MARS - Vizitën në selinë qendrore të NATO-s, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, e ka nisur takimin me ndihmëssekretarin e përgjithshëm të NATO-s për Çështje Politike dhe Politika të Sigurisë, ambasadorin Boris Ruge, si dhe zv/ndihmëssekretaren e përgjithshme për Operacione në NATO, Burcu San.

Ministrja Gërvalla shprehu falënderimin ndaj NATO-s dhe strukturave të saj civile dhe ushtarake për mbështetjen e vazhdueshme për vendin tonë,

duke u ndalur me theks të veçantë të bashkëpunimi ynë i shkëlqyer me KFOR-in dhe me NALT-in në Kosovë.

Duke marrë parasysh rolin që të dy drejtuesit dhe divizionet përkatëse e kanë në NATO, si shtylla me interes të veçantë, ministrja Gërvalla theksoi edhe domosdoshmërinë e përparimit të proceseve integruese për Kosovën në NATO deri në anëtarësimin e plotë në këtë organizatë.

Ministrja Gërvalla ka theksuar se Republika e Kosovës është e gatshme dhe e vendosur ta fillojë dialogun dhe procesin e konkretizimit të marrëdhënieve

tona, duke vënë në pah se Kosova si faktor kyç dhe i dëshmuar si kontributdhënëse për paqe dhe siguri në rajon dhe përtej i ka përqaftuar vlerat euroatlantike të cilat i ndan me aleatët, miqtë dhe partnerët ndërkombëtarë.

Vëmendje e veçantë gjatë këtij takimi kanë zënë edhe aspektet politike dhe të sigurisë në Kosovë dhe rajon, duke nënvizuar obstrukcionet dhe sulmet e vazhdueshme të Serbisë si dhe ndërhyrjet e vazhdueshme të influencave të huaja për destabilizim të Kosovës dhe rajonit, në veçanti asaj ruse në Ballkanin Perëndimor.

Arrihet marrëveshje për ndërtimin e shëtitorës afër "Urës së gurit" në Vushtrri

VUSHTRRI, 12 MARS - Komuna e Vushtrrisë dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në vlerë prej 329 mijë eurosh për projektin shëtitorja afër "Urës së Gurit". Nënshkrimi i marrëveshjes është bërë nga kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi dhe

ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka. Kryetari Idrizi është shprehur i lumtur për arritjen e kësaj marrëveshje, për të cilën ka thënë se arrin vlerën prej 329 mijë eurosh. Ai ka falënderuar ministrin Danka për mbështetjen që po i jep komunës së Vushtrrisë.

Ndërkaq ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, ka thënë se kjo është hera e dytë që kjo ministri bashkëpunon me komunën e Vushtrrisë, duke thënë se është i lumtur për arritjen e kësaj marrëveshje, e cila do të ndihmojë në zhvillimin më të mirë të komunës së Vushtrrisë.



15 stacione të reja të internetit në veri, Kurti: 140 Mbps është shpejtësia e internetit në Çabër të Zubin Potokut

Prishtinë, 12 mars - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me kryeshefen e Telekomit të Kosovës, Burbuqe Hana, ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kryetarët e Bordit dhe Sindikatës, Shpëtim Dobra dhe Lamih Balaj, drejtorin teknik, Halil Krasniqin, dhe inxhinierë e punëtorë të tjerë ishin sot në Çabër. "140 Mbps është shpejtësia e internetit në Çabër të Zubin Potokut. U bë zëvendësimi në stacionin bazë të transmetimit, me kalimin në teknologjinë

Ericsson nga ajo Alcatel. Për një montim të këtillë dikur paguheshin nga 7 500 deri 8 500 euro kompanive private gjersa të punësuarit e Telekomit nuk punonin", ka theksuar Kurti. Ai ka thënë se tash punëtorët e Telekomit instaluan edhe 15 stacione bazë të reja në veri, nga vetëm pesë sosh sa ishin më parë. "Telekomi i Kosovës udhëhiqet nga mbulimi dhe cilësia e shërbimit publik dhe jo thjesht nga përfitimi financiar vetjak. Komunikimet elektronike janë e drejtë dhe

nevojë e qytetarëve të cilat Telekomi i Kosovës i bën mundësi dhe garanci për qytetarët. Vitet 2024 dhe 2025 janë vite të Kosovës 5G. Vala në çdo cep të shtetit, në çdo vend të Republikës. Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit pati një thirrje publike të veçantë për gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës: të jenë në shërbim të Republikës e të publikut dhe jo të oligarkëve që duan ta vazhdojnë rrjepjen dhe gjymtimin e Telekomit të Kosovës", ka deklaruar Kurti.



KMDLNj: Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, prokuroria e shtetit urgjentisht ta hetojë ZRrE-në

PRISHTINË, 12 MARS - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) po e konsideron drejtësi të pjesshme vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sa iu përket faturave të fryra më 2012-2017.

Në një reagim të tyre, ky këshill kërkon hetime urgjente ndaj ZRrE-së dhe ministrave Hekuran Murati, Elbert Krasniqi, Artane Rizvanolli dhe Rozeta Hajdari për vazhdimin e trajtimit diskriminues të qytetarëve. "Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori vendim që qytetarët - konsumatorët e Kosovës që nuk janë serbë apo që nuk kanë jetuar në komunat me shumicë serbe të kompensohen me 40 milionë



euro që me vetëdije të plotë janë plaçkitur nga ZRrE përmes fryrjes së faturave në periudhën 2012-

2017, mjete që pastaj janë keqpërdorur për t'ua paguar faturat serbëve dhe të tjerëve në

me shumicë serbe. KMDLNj që nga përfundimi i luftës ka ngritur zërin për këtë diskriminim flagrant në baza etnike dhe politike të konsumatorëve të energjisë elektrike e që Avokati i Popullit, në përputhje me mandatin kushtetues, e ka adresuar këtë shkelje në gjykatat kompetente të cilat fillimisht kanë kërkuar të ndërpritet me pagesën diskriminuese të faturave dhe, në të njëjtën kohë, të kompensohen qytetarët e Kosovës nga ZRrE që në mënyrë kriminale i ka plaçkitur 95 % të qytetarëve për dobi të 5 % të qytetarëve", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se vendimi i Gjykatës

Kushtetuese të Kosovës siguron vetëm drejtësi të pjesshme (nëse ata do të kompensohen për plaçkitjet nga ZRrE), ndërsa ndjekja penale e plaçkitësve do ta bënte të plotë mozaikun e kompensimit. "KMDLNj thërret publikisht Prokurorin e Shtetit ta hetojë bazën ligjore në bazë të së cilës, që nga përfundimi i luftës iu janë paguar faturat e rrymës një 5% të qytetarëve duke dëmtuar 95%, në baza etnike dhe politike që përbënë shkelje të rëndë të drejtave të njeriut dhe që të merren masa ligjore ndaj shkelësve eventualë pavarësisht cilës qeveri i kanë takuar apo i takojnë", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Diskutohet për mundësitë e organizimit të një forumi të përbashkët ekonomik në mes të Kosovës dhe Bangladeshit

PRISHTINË, 12 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin jorezident të Bangladeshit, Mosharraf Hossain Bhuiyan, të cilin e ka falënderuar për angazhimin gjatë mandatit të tij.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e përzemërt për angazhimin e palëkundur të Bangladeshit për thellimin e marrëdhënieve dypalëshe me Kosovën dhe mbështetjen e vazhdueshme ndër vite. Në këtë linjë, presidentja Osmani shtroi nevojën e mbështetjes nga Bangladeshi për forcimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në takim u diskutua edhe për mundësitë e shkëlqyera për nxitjen e mëtejme të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare, me theks të veçantë në industrinë e tekstilit, e cila është e zhvilluar në Bangladesh. Në këtë kontekst u diskutua edhe për mundësinë e organizimit të një forumi të përbashkët ekonomik si një mundësi e shkëlqyer për bizneset nga të dyja vendet për t'i eksploruar perspektivat e bashkëpunimit në të ardhmen. Presidentja Osmani në këtë takim e ka njoftuar ambasadorin Bhuiyan edhe për edicionin e dytë të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili do të mbahet më 15-16 prill të këtij viti dhe i cili



është një mundësi e mirë për bashkëpunim dhe dialog të mëtejshëm. Një ditë më parë edhe ministri i Financave, Punës dhe

Transfereve, Hekuran Murati, është takuar me ambasadorin jorezident të Bangladeshit në Kosovë, Mosharraf Hossain Bhuiyan.

Gjatë takimit u bisedua për marrëdhëniet dypalëshe dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në fusha me interes për të dyja palët.

Ministri Murati e njoftoi ambasadorin Hossain Bhuiyan lidhur me përparësitë e të investuarit në Kosovë, duke nënvizuar moshën e re të popullsisë dhe nivelin e tatimit në të ardhurat e korporatave si fakte këto që e bëjnë Kosovën një vend tërheqës për investime të huaja.

Ndërsa ambasadori shprehi gatishmërinë për bashkëpunim ndërbiznesor në mes të bizneseve të Kosovës dhe atyre të Bangladeshit.

AKB-ja: Mbi 1 milion euro kosovarët shpenzojnë për fundjavë në Greqi

PRISHTINË, 12 MARS - Aleanca Kosovare për Biznes (AKB) ka thënë se nga liberalizimi i vizave për Kosovën më së shumti po përfitojnë shtetet që tradicionalisht ishin të vizituara nga kosovarët deri rreth vitit '91. Sipas AKB-së,

Greqia po bëhet vendi më i pëlqyer i qytetarëve të Kosovës për të vizituar gjatë javës, sidomos pas janarit të këtij viti. "Greqia po bëhet vendi më i preferuar i kosovarëve për të vizituar gjatë javës, sidomos pas janarit të këtij viti që


mesatarisht në javët e kaluara kanë ikur mbi 2 500 vizitorë për vikend për të vizituar Selanikun dhe vendet e tjera të Greqisë. Mesatarisht po shpenzojnë mbi 1 milion euro për konsume, sigurime të makinave dhe shopin", kështu

thuhet në studimin e AKB-së. Sipas Shahinit, këtë po e bëjnë të mundur edhe organizimet të ndryshme me autobus të disa kompanive dhe agjencive turistike me oferta të lira nga Kosova për të shkuar në Selanik për vetëm 8 euro.



Elon Musk vs OpenAI:

Gjigantët e teknologjisë po e nxisin frikën ekzistenciale për t'iu shmangur hetimit



Nga: **Kenan MALIK**

The Guardian

Përkthimi: **Agron SHALA**
Telegrafi.com

Në vitin 1914, në prag të Luftës së Parë Botërore, HG Wells botoi romanin për mundësitë e një zjarri më të madh. Vepra Bota e Çliruar [World Set Free] paramendoj – 30 vjet përpara Projektit Manhattan – krijimin e armëve atomike që ia mundësojnë “njeriut të mbajë në një çantë dore sasi latente të energjisë, të mjaftueshme për ta shkatërruar gjysmën e një qyteti”. Lufta globale shpërtheu duke çuar në një apokalips atomik. Kërkohet “krijimi i një qeverie botërore” për të sjell paqen. Ajo që shqetësonte Wellsin nuk ishin thjesht rreziqet e një teknologjie të re, por ishin gjithashtu rreziqet e demokracisë. Qeveria botërore e Wellsit nuk u krijua me vullnetin demokratik, por u imponua si diktaturë e mirë. “Të qeverisurit do ta tregojnë pëlqimin e vet me heshtje”, thotë në mënyrë kërcënuese Egberti, mbreti i Anglisë. Për Wellsin, “njeriu i zakonshëm” ishte “budalla i dhunshëm në çështjet sociale dhe publike”. Vetëm një elitë e arsimuar, me mendje shkencore, mund ta “shpëtojë demokracinë nga vetja”.

Një shekull më pas, një teknologji tjetër provokon një lloj të ngjashëm frikësimi – inteligjenca artificiale [AI]. Nga dhomat e bordeve të Luginës së Silikonit e deri te dhomat e Davosit, liderët politikë, manjatët e teknologjisë dhe shkencëtarët gëzohen për

përfitimet e pafundme që do të sjellë AI-ja, por kanë frikë se mund të lajmërojë gjithashtu vdekjen e njerëzimit – meqë makinat superinteligjente do ta sundojnë botën. Dhe, si një shekull më parë, në qendër të debatit janë çështjet e demokracisë dhe të kontrollit shoqëror.

Në vitin 2015, gazetari Steven Levy e intervistoi Elon Muskun dhe Sam Altmanin, dy themeluesit e OpenAI-së, të kompanisë së teknologjisë që në ndërgjegjen e publikut shpërtheu dy vjet më parë pas lëshimit të ChatGPT-së – të çetbotit në dukje të ngjashëm me njeriun. Një galaktikë e peshave të rënda të Luginës së Silikonit, e frikësuar nga pasojat e mundshme të AI-së, e krijoi kompaninë si trust jofitimprurës bamirësie, me synimin për të zhvilluar teknologjinë në mënyrë etike – për të përfituar “njerëzimi në tërësi”.

Levy e pyeti Muskun dhe Altmanin për të ardhmen e AI-së. “Ka dy shkolla mendimi”, mendoi Musk. “Doni më shumë AI apo më pak AI? Mendojmë se më shumë është më mirë”.

“Nëse unë jam Dr. Evil [Ligësia] dhe e përdor atë, a nuk do të më fuqizojë kjo?” – pyeti Levy. Dr. Evil ka më shumë gjasa të fuqizohet, u përgjigj Altman, nëse vetëm teknologjinë: “Atëherë ne vërtet jemi në një vend të keq”.

Në realitet, ai “vend i keq” po ndërtohet nga vetë kompanitë e teknologjisë. Musku, i cili u largua nga bordi i OpenAI-së gjashtë vjet më parë për të zhvilluar projektet e tij të AI-së,

tani po e padit kompaninë e tij të mëparshme për shkelje të kontratës – për shkak të vendosjes së fitimeve përpara të mirës publike dhe për shkak të dështimit për të zhvilluar AI-në “për të mirën e njerëzimit”.

Në vitin 2019, OpenAI e krijoi një filial fitimprurës për të mbledhur para nga investitorët, veçanërisht nga Microsoft-i. Kur e lansoi ChatGPT-në në vitin 2022, funksionet e brendshme të modelit u mbajtën të fshehura. Ishte e nevojshme të ishte më pak i hapur, pohoi Ilya Sutskever – një nga themeluesit e tjerë të OpenAI-së dhe në atë kohë shkencëtar kryesor i kompanisë – në përgjigje ndaj kritikave për të parandaluar, ata me qëllime keqdashëse, nga përdorimi “për të shkakuar dëm të madh”. Frika nga teknologjia është bërë mbulesë për krijimin e mburojës për hetim.

Në përgjigje të padisë së Muskut, OpenAI javën e kaluar publikoi një seri të letrave elektronike – midis Muskut dhe anëtarëve të tjerë të bordit. Këto bëjnë të qartë se, që nga fillimi, të gjithë anëtarët e bordit ranë dakord që “OpenAI” në fakt nuk mund të ishte e hapur. Teksa AI-ja zhvillohet, Sutskeveri i shkroi Muskut se “ka kuptim të fillojmë të jemi më pak të hapur. Open [hapja] në openAI do të thotë se të gjithë duhet të përfitojnë nga frytet e AI-së – pas ndërtimit të saj – por, është krejtësisht në rregull që të mos e këmbëjmë shkencën”. “Po”, u përgjigj Musk. Çfarëdo që mund të thotë padia e tij, Musku nuk është më i hapur ndaj hapjes sesa manjatët e tjerë të teknologjisë. Sfida ligjore ndaj OpenAI-së është

më shumë një luftë për pushtet brenda Luginës së Silikonit sesa një përpjekje për të sjell llogaridhënie.

Wellsi e shkroi veprën Bota e Çliruar në një kohë të trazirave të mëdha politike, kur shumëkush e ka vënë në dyshim idenë e shtrirjes së drejtës së votës për klasën punëtore.

“A ishte e dëshirueshme, a ishte madje e sigurt t’i besohej [masave]”, pyeti Fabian Beatrice Webb, “me kutinë e votimit, me krijimin dhe kontrollin e qeverisë së Britanisë së Madhe, me pasurinë e saj të madhe dhe zotërimet e saj të largëta”? Kjo gjithashtu ishte pyetja në qendër të romanit të Wellsit – se kujt mund t’i besohet e ardhmja?

Një shekull më vonë, përsëri e kemi një debat të ashpër për virtytet e demokracisë. Për disa, trazirat politike të viteve të fundit kanë qenë produkt i demokracisë së tepërt, i lejimit të irracionaleve dhe të të paarsimuarve që të marrin vendime të rëndësishme. “Është e padrejtë t’ua ngarkosh njerëzve të thjeshtë e të pakualifikuar përgjegjësinë për të marrë vendime historike”, siç ka thënë Richard Dawkins pas referendumit të BREXIT-it – një ndjesi me të cilën Wellsi do të pajtohej.

Për të tjerët, është pikërisht përbuzja e tillë për njerëzit e zakonshëm që ka ndihmuar në krijimin e deficitit demokratik në të cilin pjesë të mëdha të popullsisë ndjehen të privuara për t’u shprehur për mënyrën se si drejtohet shoqëria.

Është përbuzje që ushqehet edhe në diskutimet e teknologjisë. Ashtu si në Botën e Çliruar, debati i

AI-së përqendrohet rreth pyetjeve jo vetëm për teknologjinë, por edhe për hapjen dhe kontrollin. Pavarësisht alarmit, jemi shumë larg nga makinat “superinteligjente”. Modelet e sotme të inteligjencës artificiale, të tilla si ChatGPT ose Claude 3 – e lëshuar javën e kaluar nga një kompani tjetër e AI-së, Anthropic – janë aq të mira në parashikimin se cila duhet të jetë fjala tjetër në një sekuençë, saqë mund të na mashtrjnë duke paramenduar se në bashkëbisedim mund të jetë një person i ngjashëm me njeriun. Megjithatë, nuk janë inteligjentë në asnjë kuptim njerëzor, kanë kuptim të papërfillshëm për botën reale dhe nuk janë gati ta shuajnë njerëzimin.

Problemet që paraqet AI-ja nuk janë ekzistenciale, por sociale. Nga paragjykimi algoritmik te mbikëqyrja masive, nga dezinformimi dhe censura e deri te vjedhja e të drejtave të autorit, shqetësimi ynë nuk duhet të jetë që makinat një ditë mund të ushtrojnë pushtet mbi njerëzit, por që ato tashmë punojnë në mënyrat që përforcojnë pabarazitë dhe padrejtësitë, duke ofruar mjetet me të cilat ata që janë në pushtet mund ta konsolidojnë autoritetin.

Kjo është arsyeja se pse ajo që ne mund ta quajmë “manovra Egbert” – këmbëngulja se disa teknologji janë aq të rrezikshme saqë duhet të jenë përtej presionit demokratik dhe të kontrollohen nga disa të zgjedhur – është kaq kërcënuese. Problemi nuk është vetëm Dr. Evil, por ata që e përdorin frikën e Dr. Evilit për ta mbrojtur veten nga hetimi. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sot tri ndeshje në Superligë, derbi Malisheva - Llapi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 12 mars - Java e 25-të në Albi Mall Superligë do të sjellë tri ndeshje sot (e mërkurë) dhe dy nesër (e enjte). Padyshim ndeshja kryesore pritet të zhvillohet në stadiumin "Liman Gegaj", ku Malisheva dhe Llapi e ndajnë mejdanin. Aktualisht këto dy skuadra janë në pjesën e sipërme të tabelës, ndërsa që të dyja kërkojnë maksimumin e pikëve. Malisheva pësoi humbje në fundjavë nga Ballkani dhe tash synim ka t'u rikthehet rezultateve pozitive, në anën tjetër Llapi është vetëm një pikë prapa Ballkanit dhe nuk mendon për dështim në asnjë ndeshje pasi po beson se mund ta arrijë titullin e kampionit. Ndërsa kryesuesi dhe kampioni në fuqi i elitës, Ballkani, luan ndaj Fushë-Kosovës në një ndeshje aspak të lehtë për faktin se "Pampurat" kanë filluar të

marrin rezultate pozitive dhe synojnë t'i ndalin edhe kampionët. Çdo rezultat tjetër përveç fitores do të ishte gabim trashanik për klubin që drejtohet nga Ilir Daja. Sot përballen edhe Gjilani dhe Liria. Gjilanasit kërkojnë tri pikët në mënyrë që të ngrehen në renditjen tabelore, në anën tjetër Liria është e fundit me vetëm dhjetë pikë dhe ka pak gjasa për të shpëtuar nga rënia në Ligën e Parë. Tri ndeshjet zhvillohen nga ora 13:00. Të enjten zhvillohen dy ndeshjet e tjera, ku spikat përballja në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit, klube këto që renditen në pozitën e katërt dhe të pestë. Tri pikët janë synim i klinasve dhe kryeqytetasve. Në po të njëjtën ditë zhvillohet edhe përballja në mes të Feronikelit 74 dhe Dritës. "Nikli" do të përpiqet t'i befasojë gjilanasit dhe t'i shtojë pikët për një renditje më të mirë në

renditjen tabelore, ndërsa Drita që llogaritet në garë për titull do të kërkojë fitore në mënyrë që të mbesë në hap me Llapin dhe Ballkanin.

SUPERLIGA

Të mërkurën takohen:
13:00 Fushë Kosova - Ballkani
13:00 Gjilani - Liria
13:00 Malisheva - Llapi

Të enjten takohen:
13:00 Prishtina - Dukagjini
13:00 Feronikeli 74 - Drita

Tabela		Pikë
1. Ballkani	24	51
2. Llapi	24	50
3. Drita	24	46
4. Malisheva	24	41
5. Prishtina	24	34
6. Dukagjini	24	31
7. Feronikeli 74	24	26
8. Gjilani	24	22
9. Fushë Kosova	24	16
10. Liria	24	10

SHKURT

Ambasadori Rohde pret në takim trajnerin e ri të Kosovës, Franco Foda

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, e ka mirëpritur në zyrë trajnerin e ri të Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Franco Foda. "E mirë për të mirëpritur trajnerin e ri të Përfaqësueses së Kosovës, Franco Foda, dhe ekipin e tij në zyrën time! Duke qenë vetë entuziast i futbollit, diskutuam për sfidat dhe perspektivat aktuale të ekipit kombëtar të Kosovës. Krahas GenSec Markus Weidner, trajneri i ri thekson angazhimin e fortë të Federatës së Futbollit të Kosovës", ka shkruar Rohde në "X".

Hovenieri uron Donjeta Sadikun: Shembull tjetër i sportistëve të mëdha të Kosovës

Bokserja e Kosovës, Donjeta Sadiku, e siguroi pjesëmarrjen në Lojëra Olimpikë "Parisi 2024". Pas këtij suksesi, Sadiku ka marrë shumë urime në mesin e të cilëve edhe nga ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier. "Një shembull tjetër i shkëlqyer i sportistëve të mëdha të Kosovës! Urime Donjetës për këtë arritje të pabesueshme! Puna dhe përkushtimi juaj shërben si frymëzim për gratë dhe vajzat e Kosovës në sport", ka shkruar Hovenieri në "X". Donjeta është bokserja e parë nga Kosova që fiton kuotë për dy Olimpiada.

Ademi viziton punimet në stadiumin 'Rexhep Rexhepi' në Drenas

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka vizituar punimet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, ku po punohet intensivisht për ta përgatitur për kategorizim nga UEFA dhe për ndeshje ndërkombëtare të klubeve tona. "Përgëzova kryetarin e komunës, Ramiz Lladrovci, për përkushtimin e tij për sportin, veçanërisht për futbollin dhe për rregullimin e një stadiumi të tillë. Uroj që ky impiant sportiv në korrik të këtij viti të jetë i gatshëm me të gjitha kriteret", ka shkruar Ademi në "Facebook".

Mediumi rumun: Aston Villa e dëshiron Rrahmanin

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Albion Rrahmani, mund të transferohet shumë shpejt në Premierë Ligë. Sipas medieve rumune, është skuadra e Aston Villas që ka shprehur interesim për sulmuesin e Kosovës. Ka qenë trajneri Unay Emery ai që ka kërkuar shërbimet e Rrahmanit, që ka bërë bujë edhe në futbollin e Kosovës duke u njohur me nofken "Lewandowski". Rrahmani ka shkëlqyer te Rapid Bukureshti që nga transferimi në verën e kaluar duke realizuar 13 gola. Atë nuk e ndaloj as lëndimi i rëndë që e pësoi. Mediumet në Rumani janë duke e cilësuar Rrahmanin lojtarin më të mirë në elitën e futbollit rumun. Përndryshe, Rapid Bukureshti e bleu Rrahmanin për rreth 600 mijë euro nga skuadra e Ballkanit.

Kosova U18 do të luajë ndaj superfuqive të botës në hendboll

Prishtinë, 12 mars - Federata Ndërkombëtare e Hendbollit ka vendosur që Kampionati Botëror për të Reja (U18) të zhvillohet në Chuzhou të Kinës. Botërori mbahet prej 14 deri më 25 gusht të këtij viti. Ndeshjet do të zhvillohen në tetë arena shumë të bukura. Salla kryesore ka kapacitet prej 7 000 vendeve, ndërsa një sallë tjetër i ka 6 488 ulëse. Do të

marrin pjesë 32 ekipe kombëtare nga e mbarë bota. Pjesë e kësaj ngjarjeje të rëndësishme do të jetë edhe Kosova U18 që u kualifikua përmes IHF Trophy. Pra Kosova do të luajë me superfuqitë e hendbollit, ndërsa synon suksese. Dy kombëtare marrin pjesë me ftesë të IHF-së. Bëhet fjalë për Zvicrën dhe Islandën. IHF-ja

ende nuk ka vendosur se kur do të tërhiqet shorti për Kampionatin Botëror. Është hera e dytë që Përfaqësueset e Kosovës në hendboll garojnë në Botëror. Në vitin 2019 në Spanjë garuan hendbollistët juniorë. Ajo pjesëmarrje ishte historike, njëjtë si kjo në Kinë. Në sportet e tjera ekipe Kosova ende nuk është kualifikuar për në Botëror.



Kapllani: Cikallesi lider, Manaj po e fiton kombëtaren me dhunë

Tiranë, 12 mars - Edmond Kapllani ka analizuar formën e sulmuesve kuqezi, të cilët po shfaqin formë vërtet impresionuese në ekipet respektive. Sipas tij, Cikallesi mbetet lider i padiskutueshëm, ndërsa Manaj po e kërkon me

dhunë grumbullimin. "Kjo është gjë e mirë (forma e sulmuesve), sepse po flitet shumë se po ia bëjnë të vështirë trajnerit. Kjo është gjë e mirë. Po them dy fjalë për Cikalleshin, sepse kam luajtur me të. Është bërë lider në

kombëtare, ka shënuar në ndeshjet e fundit. Po shtoj si alternativë edhe Rey Manajn, që sikur dëshiron ta marrë me dhunë vendin. I përshtatet besoj Sylvinhos, luan me shpinë, shënon... Uzuni ka pasur formë shumë të mirë dy

vitet e fundit, por në kombëtare i ka munguar goli. Po të kishte shënuar një gol në ndeshjet e para, do të kishte qenë në formacion. Ernest Muçi është talent në rritje. Do të shohim gjëra të bukura nga ai", ka thënë Kapllani për "Supersport".



"Dikush duhet të shkojë në burg", për stadiumin e Gjilanit diskutohet në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike

PRISHTINË, 12 MARS - Gjatë ditës së hënë u raportua se Zyra e Prokurimit në Komunën e Gjilanit i ka pezulluar procedurat për rinovimin e stadiumit të Gjilanit. Për këtë çështje të martën është diskutuar edhe në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ishte deputetja e Lidhjes Demokratike dhe, njëherësh, kryetarja e këtij komisioni, Hykmete Bajrami, ajo e cila ka kërkuar informacione shtesë për arsyet e këtij pezullimi. "Ta kenë si informatë atë çfarë kam lexuar në media dje, tenderi për stadiumin e Gjilanit është anuluar prapë nga autoriteti kontaktues, që është komuna e Gjilanit", ka thënë Bajrami. Përgjigje për këtë situatë ka dhënë deputetja Mirlinda Tishukaj-Sadiku, e cila ka thënë se në procedurat për rinovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit që kanë zgjatur për shumë vjet janë gjetur shumë shkelje nga ana e auditorit dhe ajo ka thënë se për



këto shkelje dikush duhet të shkojë në burg. "Për besë çfarë kam lexuar unë në raport të auditorit aty, sidomos për stadiumin e Gjilanit, aty dikush duhet të shkojë në burg. Atë me të vërtetë prokuroria duhet t'i përvëshë mëngët sepse të bëhet një pagesë 75 për qind më shumë, të ndryshohet kontrata, të ndryshohet nga kategoria 2 në kategorinë 4 që, sipas doracakut

të UEFA-s, ajo ka ndryshim substancial në projekt, sepse po flas në aspektin profesional, ndryshon edhe numri i ulëseve, ndryshon edhe qasja, numri i parkingjeve, vendet për VIP. Ka ndryshim jashtëzakonisht të madh. Me gjithë ato të gjetura dikush duhet të qëndrojë prapa grilave dhe të mbajë përgjegjësi institucionale për atë", ka thënë Tishukaj-Sadiku.

Bostoni siguron kualifikimin në 'play-off', triumfojnë edhe Denvero dhe Golden State

PORTLAND, 12 MARS - Skuadra kampione e Denverit fitoi me rezultat 125-119 ndaj Torontos, në një përballje spektakolare mes dy ekipeve. Tjetër ndeshje e mirë për Nikola Jokiqin, që realizoi sërish një "triple double", me 35 pikë, 17 rebounde e 12 asistime. Denveri barazon Oklahomën në vendin e parë në Perëndim. Bostoni bëhet ekipi i parë në NBA këtë sezon që arrin kuotën e 50 fitoreve, duke mposhtur me rezultat 121-99 Portlandin. Browni me 37 pikë e Tatumi me 26 pikë ishin më të mirët në



fushë. Jo vetëm kaq, por Bostoni matematikisht ka siguruar kualifikimin edhe në fazën "play-off". Jashtë fushës fiton edhe Golden State, që mundi me rezultat 112-102 San Antonion.

Kuminga me 22 pikë e Thompsoni me 21 bënë dallimin në fushë. Skuadra e Dallasit, falë "triple double" të Luka Donqiqit (27 pikë, 12 rebounde, 14 asistime), mundi 127-92 Chicagon jashtë fushës.

REZULTATET

Detroit - Charlotte	114-97
Cleveland - Phoenix	111-117
Chicago - Dallas	92-127
San Antonio - Golden State	102-112
Denver - Toronto	125-119
Portland - Boston	99-121

Numri 123 në botë eliminon Djokoviçin

E pabesueshme në turneun Masters të Indian Wells për meshkuj në tenis. Italiani Luca Nardi, numri 123 në botë, mundi 2-1 serbin Novak Djokoviç, numrin 1 në botë (6-4, 3-6, 6-3). Një rezultat befasues, teksa edhe

vetë Djokoviçin nuk e beson pas përfundimit të ndeshjes. Falë këtij suksesi, Nardi kualifikohet në 1/16 e turneut të parë Masters të këtij viti për meshkuj. "Kjo është një mrekulli. Unë jam një djalë 20-vjeçar, i 123-ti në botë dhe e

munda Novakun. Është çmenduri, çmenduri", ka thënë Nardi pas fitores, duke vënë duart në fytyrë nga gëzimi. Ndërsa Djokoviç, që luante për herë të parë pas pesë vjetësh në Indian Wells, ka thënë: "Nardi nuk

kishte se çfarë të humbiste, luante në këtë turne si 'humbësi me fat'. Gjithsesi, ai e meritonte të fitonte. Unë u befasova më shumë nga niveli im, i cili ishte vërtet shumë i keq". Nardi bëhet tenisti me renditjen më të ulët (numri 123 në

botë) që arrin ta mund Djokoviçin në një turne. Ai luajti mirë, theu mbrojtjen e serbit dhe kombinoi goditje të fuqishme nga baza me sulme në kohë dhe precize, duke arritur kështu një sukses të madh në aspektin sportiv.

SHKURT

Uzuni, pjesë e formacionit të javës në La Liga

Myrto Uzuni ka shkëlqyer në javën e 28-të në La Liga. Ai e ka siguruar një vend në formacionin e kësaj xhiroje. Përkundër se ekipi i tij, Granada, pësoi humbje 3-2 nga Real Sociedad, reprezentuesi i Shqipërisë ishte në formën e tij më të lartë. Uzuni realizoi dy gola në këtë takim, ndërsa ekipi i tij duhej të mbetej duarbosh nga kjo përballje, por që sulmuesi shqiptar mori meritat e tij. I vlerësuar me notën 8.1 nga SofaScore, lojtari është përkrah emrave të mëdhenj si Luka Modriç, Edouard Camavinga, Lucas Vazquez. Formacioni: Rajkoviç, Vazquez, Chust, Le Normand, Ocampos, Camavinga, Modriç, Tsyganov, Uzuni, Sorloth, Juanmi.

Chelsea do t'i shesë pesë lojtarë, mes tyre edhe Brojën

Shpenzimet e shumta të Chelseat në merkato e fundit duket se do t'i kushtojnë shumë klubit londinez, i cili është i detyruar të kryejë shitje deri në 120 milionë euro për të shpëtuar nga "Fair Play Financiar". Në Angli duket se kanë zbuluar pesë emrat që do të largohen këtë verë nga "Blutë" dhe një prej tyre është edhe Armando Broja. Sulmuesi i kombëtares shqiptare për momentin luan i huazuar te Fulhami, por pritet që mos të shitet aty dhe të kthehet sërish te Chelsea në verë. Kështu "Blutë" janë të gatshëm t'i dëgjojnë të gjitha ofertat që do të vijnë në drejtim për Brojën, teksa thuhet se interes për të ka shfaqur edhe Milani. Përveç Brojës, emrat e tjerë që thuhet se do të shiten nga Chelsea janë Romelu Lukaku, Hakim Zijeh, Kepa Arrizabalaga dhe Malang Sarr.

Upamecano: Nuk e mendoj largimin nga Bayerni

Dayot Upamecano kohët e fundit është kritikuar për paraqitjet e tij dhe në disa ndeshje trajneri Thomas Tuchel e ka lënë në bankën rezervë. Megjithatë kjo nuk ka ndikuar aspak që mbrojtësi francez të mendojë të largohet nga Bayern Muncheni, madje ai ka konfirmuar se është i lumtur në klubin gjerman. "Kam një kontratë deri në vitin 2026 me Bayernin dhe jam i lumtur këtu. Nuk e mendoj fare largimin nga ky klub. Unë dua të qëndroj këtu në Bayern dhe do të vazhdoj të punoj për këtë qëllim", u shpreh Upamecano për të përditshmen "Kicker". 26-vjeçari në Bayern erdhi nga RB Leipzig në vitin 2021 për mbi 40 milionë euro dhe ka bërë 107 paraqitje për "bavarezët" me tre gola dhe tetë asistime.

Sarri rrezikon shkarkimin nga Lazio

Lazio nuk po kalon nëpër formë të mirë dhe humbja 1-2 nga Udinese ishte e treta radhazi. Këtë humbje nuk e ka përtypur presidenti Claudio Lotito, ku menjëherë pas përfundimit të ndeshjes ka shkuar në dhomat e zhveshjes dhe ka urdhëruar skuadrën të hyjë në grumbullim deri në fund të javës. Ndërkohë, trajneri Maurizio Sarri është me një këmbë jashtë klubit, pasi në Itali aprovon se tekniku toskan ka përfunduar ciklin e tij te Lazio. Tashmë do të jetë Lotito ai që do të vendosë për të ardhmen e stolit të trajnerit, ku fitorja është detyrim për Sarrin pasi, përndryshe, do të shkarkohet menjëherë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ordinanca Specialistike e Ortononcisë Idealine” Sh.P.K. me seli në Gllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811381441 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ordinanca Specialistike e Ortononcisë Idealine” D.O.O. od Gllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811381441 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Ordinanca Specialistike e Ortononcisë Idealine” L.L.C. with headquarters Gllogoc, has come to the decision to quit its business: 811381441 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “LR GROUP” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811563049, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “LR GROUP” D.O.O. od Prishtine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811563049, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “LR GROUP” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811563049, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “K.B. Fusha E Art K.B.” me seli në Gllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811181106 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “K.B. Fusha E Art K.B.” Gllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811181106 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “K.B. Fusha E Art K.B.” Gllogoc, has come to the decision to quit its business: 811181106 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “YLLI” Sh.P.K. me seli në Gllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810252552 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “YLLI” D.O.O. od Gllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810252552 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “YLLI” L.L.C. with headquarters Gllogoc, has come to the decision to quit its business: 810252552 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Institucion i Arsimit dhe Aftësisit Profesional
(IAAP) "Ymer Prizreni" Prizren
e-mail: mgavazaj@hotmail.com
Nr.tel.038/20035377
facebook:"Ymer Prizreni"



Nr prot.235
Datë 12/03/2024

FTESE PËR OFERTË

Për eskursionin e maturantëve të IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren në Republikën e Shqipërisë .

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Kompanitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur, për eskursionin e maturantëve të IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren për në Republikën e Shqipërisë ,më datën 12/05/2024 deri më datën 16.05.2024 .

Pjesëmarrësit e interesuar në tender për dokumentacionin dhe kushtet e kërkuara nga ana e shkollës i kanë të paraqitura në aplikacion.

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuar me dokumentacionin të dorëzohen në DKA në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë kalendarike, nga dita e publikimit në gazetë.

Të interesuerit aplikacionet mund t'i tërheqin në lokalet e shkollës prej orës 8:00 deri në orën 15:00 dhe atë gjatë ditëve të punës.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve nuk mund të bëhet ditën e shtunë dhe të diel, për shkak se keto dy ditë nuk punon administrata e shkollës.

Shkolla mban të drejtën për anulimin e ofertës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Meriton Bajrami shpall te pavlefshme 3 dëftesa , diplomën , gjendjen e notave dhe mungesave Q.K. "11 Marsi" Prishtine.

- Fatjon Stolliqi shpall te pavlefshme diplomën Q, K. "11 Marsi" Prizren.

- Gazmend Shala shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Enis Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI-IX të sh.f.m.u. "VII Morina" Gjakovë.

- Naim Morina nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f "Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Bleart Avdullahi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të sh.m.t "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Operator Prodhimi.

- Besart Zhubi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Makina Elektrike Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



